



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.399, datë:02.12.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, Kontrata Sh.02.Nr.32762 e datës 26.11.2025, nenit 70, paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxheres së kontratës dhe të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të menaxheres së kontratës

1. Caktohet menaxherja e kontratës dhe mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e menaxheres së kontratës me titull: **"Ndërtimi i varrezave në Hodonoc"**, me numër të kontratës **KM653-25-8970-5-2-1**, si në vijim:
 - 1.1. **Znj. Vlonë Matoshi** (Drejtorja për Investime Kapitale), **CAKTOHET** menaxhere e kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 **Znj. Vjollcë Kryeziu** (Drejtorja për Investime Kapitale), **CAKTOHET** mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e menaxheres së kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxherja e kontratës dhe mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e menaxheres së kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe manualët për përdorim të modulit për menaxhim të kontratës.
3. Të dërgohet raport i rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- znj. Vlonë Matoshi (Drejtorja për Investime Kapitale);
- znj. Vjollcë Kryeziu (Drejtorja për Investime Kapitale); dhe
- QSHQ-arkivi.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E KAMENICES - OPŠTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z. /S.	Nr./Br./No.
02	33501
Nr i faq Br. Str No Pg	Data Datum Dati
01	05/12/
KAMENICË - KAMENICA 2025	

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.400 datë: 02.12.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, Kontrata Sh.02.nr.32986 e datës 01.12.2025, nenit 70 pika b) të Statutit Sh.01.nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës, merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës me titull: **"Furnizim i një ekrani LED të jashtëm për informata të qytetit"**, me numër të kontratës **KM 653-25-10057-1-3-6**, si në vijim:

1.1. z. Edmond Kastrati (DKA), CAKTOHET menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Të dërgoj raport të rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Edmond Kastrati (DKA); dhe
- QSHQ-arkivi.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



Zyra e Kryetarit

Sh.02 Nr.405, datë: 08.12.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 70 paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.nr.20203 të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Arsyetimi për Faturën me numër protokolli Sh.02.Nr.33661 i datës 08.12.2025 nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kryetari i Komunës merr këtë:



V E N D I M

Për lejimin e pagesës së faturës Nr. 0038067 të datës 28.11.2025

1. Lejohet pagesa e faturës Nr. 0038067 të datës 28.11.2025, me numër fiskal Nr.0019 në shumë prej 157.50 € për shpenzimet e krijuara në "Fast Food-Linda" në Kamenicë, me rastin e Festës së Flamurit Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka organizuar aktivitete të shumta kulturore e sportive, ndër aktivitetet sportive ishte edhe turneu i voleybollit, ku morën pjesë një numër i konsiderueshëm i klubeve të voleybollit të femrave, pas përfundimit të turneut për të gjitha pjesëmarrëset në këtë aktivitet u shtrua një drekë modeste.
2. Pagesa të bëhet nga kodi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, në xhirollogarinë bankare të paraqitur në faturë e cila është e bashkangjitur në shtojcë të këtij vendimi.
3. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Financave dhe Buxhetit në Kamenicë në pajtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
4. Vendimit i bashkangjitet Arsyetimi për Faturën me numër protokolli Sh.02.Nr.33661 i datës 08.12.2025, fatura Nr. 0038067 të datës 28.11.2025, në shumë prej 157.50 €, Kuponi fiskal me numër 0019 i datës 28.11.2025, dhe fotografitë lidhur me aktivitetin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendim t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- DKRS-së;
- DBF-së ;dhe
- QSHQ - Arkivit.

Kryetar i Komunës
Kadri Rahimaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA




Zyra e Kryetarit

Sh.02 Nr.406, datë: 08.12.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 70 paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.nr.20203 të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Arsyetimi për Faturën me numër protokolli Sh.02.Nr.33662 i datës 08.12.2025 nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e pagesës së faturës Nr. 0062172 të datës 28.11.2025



1. Lejohet pagesa e faturës Nr. 0062172 të datës 28.11.2025, me numër fiskal Nr.0026 në shumë prej 288 € për shpenzimet e krijuara në Restaurant “Ardi” SH.P.K, në Kamenicë, me rastin e Ditës së Flamurit- Përvjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përveq aktiviteteve të tjera organizoi një koncert madhështor ku morën pjesë grupe muzikore e ansamble folklorike, pas përfundimit të koncertit për këngëtarët dhe valltarët që morën pjesë DKRS shtroi një drekë modeste.
2. Pagesa të bëhet nga kodi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, në xhirollogarinë bankare të paraqitur në faturë e cila është e bashkangjitur në shtojcë të këtij vendimi.
3. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Financave dhe Buxhetit në Kamenicë në pajtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
4. Vendimit i bashkangjitet Arsyetimi për Faturën me numër protokolli Sh.02.Nr.33662 i datës 08.12.2025, fatura Nr. 0062172 të datës 28.11.2025, në shumë prej 288 €, Kuponi fiskal me numër 0026 i datës 28.11.2025, dhe fotografitë lidhur me koncertin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendim t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- DKRS-së;
- DBF-së ;dhe
- QSHQ - Arkivit.

Kryetar i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY
PER SHERBIME ME QYTETARE
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS
SH./Z./S. 02 Nr./Br./No. 34063
Nr. ifaq 1 Data 10/12
Br. Str. Datum
No. Pg. Dat
KAMENICE - KAMENICA 2025

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.403 datë: 08.12.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, Kontrata AQP.Nr.57/25 të datës 11.06.2025, nenit 70, paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: " **Furnizim me karburante** ", me numër të kontratës **UA/2016-25-1569-1-1-1/C689**, si në vijim:
 - 1.1. **Z. Burim Mavriqi** (DAP), **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. **Z. Besnik Kovani** (DAP), **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe manualët për përdorim të modulit për menaxhim të kontratës.
3. Të dërgohet raport i rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Burim Mavriqi (DAP);
- z. Besnik Kovani (DAP); dhe
- QSHQ-arkivi.

Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PER SHERBIME ME QYTETARE CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z./S. 02	Nr./Br./No. 34068
No. i faq. 2	Data 10/12/25
Br. Str.	Datum
No. Pg.	Ditë
KAMENICË - KAMENICA	

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.404, datë:08.12.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, nenit 71 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Vendimit bazë Sh.02.Nr.12724 e datës 22.04.2024, Vendimi Sh.02.Nr.7969 i datës 08.09.2025 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit bazë, Vendimi Sh.02.Nr.30207 i datës 27.10.2025, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Sh.02.Nr.7969 të datës 08.09.2025, Kërkesës përmes emailit zyrtar të datës 02.12.2025 nga menaxherja e kontratës znj.Vjollcë Kryeziu për aprovimin e ndryshimeve në projekt, email-it zyrtar nga zyra projektuese "Arhiko ING ", e datës 04.12.2025 për aprovimin e kërkesës për lejimin e ndryshimeve në projekt, neni 70 pika b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicë, Kryetari i Komunës, merr këtë:


VENDIM

Për lejimin e ndryshimeve (aprovimeve) në projekt

1. Miratohet kërkesa e menaxheres së Kontratës, për aprovimin e ndryshimeve në projektin: "**LOT 1-Ndërtimi i parqeve në Kamenicë - Parku te qendra e vjetër – Ritenderim**", me Nr. të prokurimit: **KM:653-24-2848-5-2-1**.
2. Ndryshimi i sasive në pozicione brenda kontratës është inicuar nga menaxherja e kontratës znj.Vjollcë Kryeziu për projektin e sipërcekur lidhur me ndryshimet në këtë projekt dhe e njëjta është aprovuar nga Kryetari i Komunës, në pajtim me dispozitat e nenit 71 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyra e Prokurimit, Menaxherja e Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Kontratës.
4. Kryetari i Komunës bazuar në kërkesën e lartcekur vendosi si në pikën (1) një të këtij vendimi.

5. Vendimit i bashkangjitet Kopjet nga Vendimi bazë Sh.02.Nr.12724 e datës 22.04.2024, Vendimi Sh.02.Nr.7969 i datës 08.09.2025 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit bazë, Vendimi Sh.02.Nr.30207 i datës 27.10.2025, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Sh.02.Nr.7969 të datës 08.09.2025, kërkesa përmes emailit zyrtar të datës 02.12.2025 nga menaxherja e kontratës znj. Vjollcë Kryeziu për aprovimin e ndryshimeve në projekt, email-i zyrtar nga zyra projektuese “ Arhiko ING “, e datës 04.12.2025 për aprovimin e kërkesës si dhe paramasa me sasi të cilat largohen dhe sasi të cilat i shtohen projektit.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.


Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës për Informim, Zyrës së Prokurimit, Studios projektuese “Arhiko ING”, Menaxheres së Kontratës znj. Vjollcë Kryeziu dhe QSHQ – Arkivit.


Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E KAMENICES - OPŠTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PËR SHERBIME ME QYTETARE CENTAR ZA USLUGU GRADANA CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z./S. <u>02</u>	Nr./Br./No. <u>34536</u>
Nr. i faq. Br. Str. No. Pg. <u>01</u>	Data Datum Dati <u>15/12/</u> <u>2025</u>
KAMENICË - KAMENICA	

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.409, datë:11.12.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, Kontrata Sh.02.Nr.30507 e datës 30.10.2025, 70, paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxheres së kontratës

1. Caktohet menaxherja e kontratës me titull: **"Marrja në shfrytëzim e paisjeve aromatike"**, me numër të kontratës **KM653-25-7582-2-3-6**, si në vijim:
 - 1.1. **Znj. Sabile Arifi** (DAP), CAKTOHET menaxhere e kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxherja e kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe manualin për përdorim të modulit për menaxhim të kontratës.
3. Të dërgohet raport i rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- znj. Sabile Arifi (DAP); dhe
- QSHQ-arkivi.

Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PER SHERBIME ME QYTETARE CENTAR ZA USLUGU GRADANA CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z./S. 02	Nr./Br./No. 34854
Nr. i ligj. Br. Str. No. Rg. 2	Data Dritum. D. 16/12
KAMENICE - KAMENICA 2025	

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.411, datë:15.12.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13, nenit 58 shkronja b) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, Vendimi Sh.02.Nr.33799 të datës 09.10.2023, për formimin e ekipës për menaxhimin e kontratës me titull; “Ndërtimi i kanalizimit fekal në Kamenicë dhe fshatrat Shipashnicë, Karaçevë, Busavatë, Kopernicë, Koretin dhe Topanicë-Ritenderim 2” me numër identifikues të prokurimit: KM653-23-7865-5-2-1, Kërkesa Sh.02.Nr.2830, e datës 05.02.2025 e parashtruar nga K.N.T.SH.”TEUTA-M” SH.P.K, për aprovimin e punëve shtesë, Paramasa dhe parallogaria e kolektorit Koretin- Shtesa, Email-it Zyrtar nga Dea Group, e datës 05.12.2025 për aprovimin e punëve shtesë dhe Kërkesa për mjetet e zotuar e datës 30.10.2025, si dhe neni 70, paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicë, Kryetari i Komunës, merr këtë

V E N D I M

PËR LEJIMIN E EKZEKUTIMIT TË PUNËVE SHITESË

Projekti: “Ndërtimi i kanalizimit fekal në Kamenicë dhe fshatrat Shipashnicë, Karaçevë, Busavatë, Kopernicë, Koretin dhe Topanicë-Ritenderim 2” me numër identifikues të prokurimit: KM653-23-7865-5-2-1

1. Me këtë vendim lejohet ekzekutimi i punëve shtesë në projektin: “Ndërtimi i kanalizimit fekal në Kamenicë dhe fshatrat Shipashnicë, Karaçevë, Busavatë, Kopernicë, Koretin dhe Topanicë-Ritenderim 2” me numër identifikues të prokurimit: KM653-23-7865-5-2-1, punimet të cilat realizohen nga K.N.T.SH.”TEUTA-M” SH.P.K, punët shtesë lejohen brenda limiteve dhe rregullave ligjore të prokurimit publik.
2. Arsyeja e lejimit të ekzekutimit të punëve shtesë është bërë me Kërkesën Sh.02.Nr.2830, datë 05.02.2025, nga K.N.T.SH.”TEUTA-M” SH.P.K, Gjatë realizimit të punimeve në terren për projektin “Ndërtimi i kanalizimit fekal në Kamenicë dhe fshatrat Shipashnicë, Karaçevë, Busavatë, Kopernicë, Koretin dhe Topanicë-Ritenderim 2”, gjatë implementimi të projektit

pasi qe është kryer pjesa e paraparë sipas kontratës bazë, duke e pastruar dhe testuar pjesën egzistuese të kolektorit është vërejtur që një pjesë nuk ka pasur fare gyp në teren të instaluar, pasi gjatë vërshimeve që kanë qenë më herët në atë pjesë komplet gypin DN800 e ka marrë lumi apo e ka devijuar prej trasesë dhe në disa pjesë është mbyllur komplet me dheun e lumit. Andaj në këtë pjesë është paraqitur nevoja që të instalohet gypi i ri DN800 e cila nuk ka qenë e paraparë me kontratën bazë dhe është më se e nevojshme që të aprovohen punët shtesë .

3. Obligohet Drejtoria e Financave dhe Buxhetit që t'i alokoj dhe zotoj mjetet financiare sipas paramases dhe parallogarisë për punë shtesë nga punëkryesi dhe menaxheri i Kontratës.
4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyra e Prokurimit dhe DBF- ja , kurse mbikqyrjen për zbatimin e tij e bën Kryetari i Komunës.
5. Vendimit i bashkangjitet Vendimi Sh.02.Nr.33799 të datës 09.10.2023, për formimin e ekipes për menaxhimin e kontratës me titull; “Ndërtimi i kanalizimit fekal në Kamenicë dhe fshatrat Shipashnicë, Karaçevë, Busavatë, Kopernicë, Koretin dhe Topanicë-Ritenderim 2” me numër identifikues të prokurimit: KM653-23-7865-5-2-1, Kërkesa Sh.10.Nr.2830, e datës 05.02.2025 e parashtruar nga K.N.T.SH.”TEUTA-M” SH.P.K, për aprovimin e punëve shtesë, Paramasa dhe parallogaria e kolektorit Koretin- Shtesa, Email-it Zyrtar nga Dea Group, e datës 05.12.2025 për aprovimin e punëve shtesë dhe Kërkesa për mjetet e zotuara e datës 30.10.2025.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërghet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës për Informim, Zyrës së Prokurimit, DBF-së, K.N.T.SH.”TEUTA-M” SH.P.K (teutam@gmail.com), z.Leotrim Spahiu (Drejtoria për Investime Kapitale), Antarëve të ekipit sipas vendimit Sh.02.Nr.33799 te datës 09.10.2023 , dhe QSHQ – Arkivit.


Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj